



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 28 Gusht 2023

Nr: 741

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 448 ID TË KOALICIONIT PËR
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA, PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14
MAJ 2023**

Sot më datë 28 Gusht 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara

SUBJEKT: Z. Erjon Veliaj, kryetar dhe kandidat për bashkinë Tiranë
Z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njesinë nr. 14 dhe Njesinë Kashar, Tiranë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91, të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92, 171, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike, për të cilën pretendohet se ka patur përdorim të burimeve shtetërore për qëllime zgjedhore.

Denoncimi është marrë nëpërmjet provave link apo provave shkresore, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë objekt denoncimi.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga personi përgjegjës për raportimin veprimtarive publike në bashkinë Tiranë, nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara si dhe datën se kur janë alokuar fondet për fillimin e investimeve për ndërtimin e çerdhes “Bota e Fëmijëve”.

Subjekti objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- Denoncimi **regjistruar me nr. 448 ID**, i administruar pranë Komisionit Qendror të më datë 18.05.2023, nëpërmjet raportit XVII të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, nëpërmjet së cilit pretendohet si më poshtë vijon:

“Më datë 10.5.2023 Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe kandidati i Partisë Socialiste për kryetar në këtë bashki (subjekt zgjedhor), ka zhvilluar një vizitë në një çerdhe të ndërtuar rishtaz në njësinë nr. 14 në Bashkinë Tiranë. Në këtë vizitë z. Veliaj ka qenë i shoqëruar nga z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njësinë nr.14 dhe Njësinë Kashar në Tiranë. KRIIK nuk ka arritur të gjejë në ndërfaqen e raportimeve një njoftim për këtë aktivitet, pra figuron që veprimtaria të jetë e pa raportuar, nga Bashkia Tiranë.”

Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie është postuar në profilin zyrtar të kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe drejtuesit politik të PS në atë zonë, z. Plarent Ndreca.

Konkretisht:

Postimi në faqen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):
“Jam shumë i lumtur që hapim sot çerdhen e re, “Bota e Fëmijë... Jam shumë i lumtur që hapim sot çerdhen e re, “Bota e Fëmijëve”, në zonën e Astirit, për t’i dhënë zgjidhje prindërve të 170 fëmijëve. Ofrojmë të njëjtin shërbim si në të gjitha çerdhet e tjera të Tiranës sepse për ne familja dhe fëmijët janë më të rëndësishëm.”

Një postim në faqen e tij Facebook lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njesinë nr.14 dhe Njësinë Kashar në Tiranë.

“ÇERDHJA MË E RE NË NJËSINË 14 #LagjaRilindja #Astir “Bota e fëmijëve” ambienti i shumpritur për banorët e zonë i çerdhes publike. Sot bashkë me Erionin, Zhanetën dhe Gentin inaguruam hapësirën e re të investimit. Tirana ecën përpara! #PS #Njesia14 #VetemPerpara #KurrePas”

Nga videot dhe fotografitë e publikuara, duket qartë prezenca edhe e fëmijëve në këtë vizitë në çerdhe, si dhe drejtoresha e institucionit dhe edukatoret.

Duke qenë se aktiviteti nuk është i raportuar në ndërfaqen e KQZ, nuk është e qartë nëse kemi të bëjmë me një aktivitet të z. Veliaj në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, apo të z. Veliaj si Subjekt Zgjedhor, Kandidat për Kryetar të Bashkisë Tiranë.

Në gjykimin e KRIIK, aktiviteti, pavarësisht nëse është institucional apo në kuadër të fushatës zgjedhore, përbën përdorim të burimeve publike dhe autoritetit shtetëror në funksion të fushatës elektorale të Subjektit Zgjedhor z. Erion Veliaj dhe Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste”.

Kodi Zgjedhor në nenin 81 pika 3 jep kuptimin e një veprimtarie elektorale përgjatë fushatës zgjedhore, e konkretisht: “Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor”. Ndërsa në nenin 91 pika 1 dhe 2, Kodi Zgjedhor përcakton se: “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime

zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Lidhur me gjithë sa më sipër, edhe nëse kjo veprimtari do të pretendohet e konsiderohet si:

(A) një takim me natyrë elektorale, atëherë evidentohen më poshtë këto shkelje:

- 1. Përdorimi i institucionit publik dhe kryerja e një aktiviteti institucional inagurimi të çerdhes, për efekt të aktivitetit elektorale.*
- 2. Aktiviteti është kryer qartas gjatë orarit zyrtar të punës.*
- 3. Pjesëmarrësit në të janë fëmijët e çerdhes, çka përbën përdorim të fëmijëve për qëllime elektorale.*
- 4. Pjesëmarrës janë drejtoresha dhe edukatoret e çerdhes në orarin zyrtar të punës, duke përdorur punonjësit e institucionit për qëllime elektorale.*

Bazuar në sa më sipër, në gjykimin e KRIIK, aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të qartë të kuadrit ligjor dhe si i tillë, KQZ-ja nevojitet të sanksionojë titullarët e Çerdhes, Kandidatin-Subjekt Zgjedhor z. Erion Veliq, si dhe Subjektin Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet.

(B) si i karakterit institucional, atëherë evidentohen më poshtë këto shkelje:

- 1. Aktiviteti është i pa raportuar në ndërfaqen e KQZ.*
- 2. Aktiviteti është inagurim, sepse çerdhja është e re, e sapo hapur dhe në statusin e publikuar nga vetë z. Veliq theksohet “Jam shumë i lumtur që hapim sot çerdhen e re, “Bota e Fëmijëve”, në zonën e Astirit, për t’i dhënë zgjidhje prindërve të 170 fëmijëve”.*
- 3. Aktiviteti është inagurim apo promovim, çka në kuptim të nenit 81 pika 3 dhe nenit 91 pika 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor është një aktivitet i ndaluar për t’u zhvilluar, gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore*
- 4. Prania e z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njësinë nr.14 dhe Njësinë Kashar në Tiranë, i jep natyrë elektorale aktivitetit.*
- 5. Pjesëmarrësit në të janë fëmijët e çerdhes, për takimin dhe shfaqjen/publikimin e fotove të të cilëve nuk dihet nëse ka dakordësi paraprake nga prindërit, dhe për këtë KQZ-ja lipset të marrë informacion.*

Aktiviteti është trasmetuar gjerësisht edhe nga media. Konkretisht disa prej tyre janë:

Top Channel <https://www.youtube.com/watch?v=Afuu77fTÇI>

Report TV <https://www.youtube.com/watch?v=sztXYN1hhrU>

RTSH <https://www.youtube.com/watch?v=WLDHVH4CAGE>

Referuar gjithë sa më sipër, në çdo rast të çfarëdo pretendimi të ngritur dhe të marrjes apo jo në konsideratë prej KQZ-së, në gjykimin e KRIIK, aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të kuadrit ligjor dhe si i tillë, nevojitet që KQZ-ja nevojitet të sanksionojë titullarët e Çerdhes, Kryetarin e Bashkisë z. Erion Veliaj, si dhe subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet.”

Më datë 18.5.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë i është kërkuar informacion sqarues në lidhje me sa pretendohet nga denoncuesi.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 707, datë 18 Korrik 2023 ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 448 ID.

Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare në lidhje me çështjen objekt gjykimi përpara se të vijohet me vendimmarrje.

Nëpërmjet adresës së e-mail, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë, ndër të tjera bën me dije se “ Në lidhje me denocimin e paraqitur për një çerdhe të ndërtuar rishtaz në njësinë nr. 14 në Bashkinë Tiranë. Në këtë vizitë z. Veliaj ka qenë i shoqëruar nga z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njësinë nr.14 dhe Njësinë Kashar në Tiranë. KRIIK nuk ka arritur të gjejë në ndërfaqen e raportimeve një njoftim për këtë aktivitet, pra figuron që veprimtaria të jetë e pa raportuar, nga Bashkia Tiranë. ju bejme me dije se:

Kemi të bëjmë me një ambient të marrë me qira nga Bashkia Tiranë dhe i gjithë mobilimi është kryer nëpërmjet donacioneve nga disa subjekte, pra nuk kemi të bëjmë me fonde publike dhe parashikime buxhetore nga Bashkia Tiranë.

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar nenin 2, shkronja “b” të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përcakton se, veprimtari publike janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1, të nenit 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë

informimin në periudhën katërmujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

Referuar nenit 3, pika 1, nëndarja 1.1, “Veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;...

ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.

Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 përcakton se, veprimtari të ndaluara janë ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me fonde të vëna rishtazi dhe as me fonde publike të transferuara jo sipas planit buxhetor të miratuar.

Në mënyrë që të kemi shkelje të shkronjës “a” ... mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut dhe shkronjës “ç”... mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi”, duhet që fondet e përdorura për promovimin e këtyre objekteve të ishin vendosur rishtazi apo posaçërisht në dispozicion dhe të ishin transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Këto janë kushte komulative të përcaktuara nga neni 3, dhe nuk mund të lexohen të ndara nga njëra-tjetra. Sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar kryetari i bashkisë Tiranë, është në shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për mosraportim të veprimtarisë publike, vlerësoj se pas analizimit të fakteve si dhe kryerjes së hetimit administrativ, provohet qartazi se kryetari i

bashkisë ka qënë në kuadër të detyrave të tij funksionale si kryetar bashkie. Në këto kushte përmbushja e detyrave funksionale për një veprimtari publike, nuk mbart detyrim për raportim

Për sa i përket pretendimit se punonjës të çerdhes si drejtoresha dhe edukatorët janë përdorur për qëllime elektorale, nuk qëndron. Në referim të nenit 91 pika 1 *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”*, gjithashtu dhe në referim të pikës 2 të po këtij neni, *“...Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore”*. Në asnjë rast nuk u provua që pjesëmarrja e punonjësve të kësaj çerdhe ka qënë e detyruar, ata kanë qënë në përmbushje të detyrave të tyre funksionale gjatë punës rutinë të kryetarit të bashkisë.

Në matarialin e paraqitur si provë, qartazi stafi nuk është bërë pjesë e promovimit elektoral si pretendohet nga denoncuesi, pasi është lehtësisht e evidentueshme që janë në funksion të detyrës së tyre.

Në lidhje me pjesëmarrja e deputetit të zonës apo e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral.

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit”, deputeti gëzon një status të veçantë në marrëdhëniet juridike që ka me gjithë organet qendrore dhe vendore në vend. Pjesëmarrja e tij në aktivitetet e organizuara nga kryetari i bashkisë nuk e kthen aktivitetin domosdoshmërisht në një takim elektoral. Si pjesë e detyrave funksionale të tij, deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrave të kryetarit të bashkisë. Megjithatë, këto takime nuk duhet të shfrytëzohen për kryerjen e thirrjeve elektorale apo përcjelljen e mesazheve me përmbajtje të tillë.

Të ndodhur në kushte nuk u provua që z. Plarent Ndreca, në cilësinë e Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njesinë nr. 14 dhe Njësinë Kashar, Tiranë të ketë përdorur këtë takim për kryerje të fushatës elektorale në mbështetje të kandidatit për kryetar bashkie apo të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Në këto kushte vlerësoj se nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për denoncimin e kryer nga KRIIK, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria publike e

kryer nga kryetari i bashkisë Tiranë, dhe Drejtuesi Politik i Partisë Socialiste për Njësine nr. 14 dhe Njësine Kashar, Tiranë, pasi nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 dhe 171, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj:
 - Z. Erion Veliaj, kryetar i bashkisë Tiranë;
 - Z. Plarent Ndreca, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Njësine nr. 14 dhe Njësine Kashar, Tiranë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI